


Doracak i Mjeteve për Avokim
**KOMUNIKIMI I
QASSHËM DREJT
GJITHËPËRFSHIRJES**



Doracaku (Toolkit) i mjeteve për Avokim nga CARITAS Kosova

Projekti **ACTIVE II** **Komunikimi i Qasshëm** **drejt Gjithëpërfshirjes**



Qëllimi i Doracakut:

Kjo përmbledhje është zhvilluar për të mbështetur organizatat e personave me aftësi të kufizuara (DPO) dhe organizatat e shoqërisë civile (OJQ) në përpjekjet e tyre për të promovuar komunikimin e qasshëm në nivel lokal.

Ajo përmban udhëzime praktike, modele dhe rekomandime për të ndikuar në përfshirjen e komunikimit të qasshëm në dokumente strategjike dhe/ose normative, si dhe në legjislacionin vendor.

Për kë është ky doracak?



Organizata të personave me aftësi të kufizuara (DPO)



Organizata të shoqërisë civile (OJQ) që punojnë për përfshirje sociale



Grupe të vetë-avokimit



Institucione publike dhe ofrues shërbimesh publike



Vendimmarrës nga niveli Lokal dhe Qendror



Media, aktorë të fushës së IT dhe arsimit



Përmbajtja e Dorakacut

1. Kuptimi i Komunikimit të Qasshëm

• **Çfarë është komunikimi i qasshëm?** Komunikimi i qasshëm është procesi i krijimit dhe shpërndarjes së informacionit në një mënyrë që të mund të kuptohet nga të gjithë, pavarësisht aftësive, moshës apo prejardhjes. Ai përfshin përdorimin e materialeve në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, si dhe mjeteve vizuale dhe dixhitale të aksesueshme.

• **Pse është i rëndësishëm?** Komunikimi i qasshëm është i rëndësishëm sepse kontribuon në reduktimin e pabarazive sociale dhe ekonomike. Ai mbështet dhe promovon të drejtat e njeriut duke i dhënë zë grupeve të marginalizuara. Për më tepër, projekti ACTIVE 2 mbështet zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe strategjive përkatëse kombëtare të zbatimit.

• **Kush përfiton?** Përfituesit e projektit dhe të komunikimit të qasshëm janë persona me aftësi të kufizuara, persona me demencë, persona të moshuar, pjesëtarë të komuniteteve pakicë, persona me vështirësi në shkrim dhe lexim, persona me vështirësi në përqendrim (ADHD) dhe persona me gjuhë të tjera amtare.

Parimet bazë:

- 1 **Qartësia:** Përdorni fjalor të thjeshtë dhe fjali të shkurtra. Shmangni zhargonin dhe shprehjet e komplikuar.
- 2 **Thjeshtësia:** Prezentoni një ide kryesore për fjali. Krijoni materiale me faqe të thjeshta dhe të pa-mbushura.
- 3 **Struktura:** Përdorni tituj, nëntituj dhe lista për të strukturuar informacionin në mënyrë logjike.
- 4 **Gjuha e Lehtë:** Përshtatni tekstet në gjuhë të thjeshtë (Easy-to-Read) dhe gjuhë të qartë (Plain Language).

2. Udhëzues për Planifikimin e Avokimit

Si të përcaktoni një qëllim avokimi: Përcaktoni një qëllim specifik dhe të matshëm. Për shembull: Të ndikoni që një komunë të zhvillojë dhe miratojë një strategji (politikë apo qasje) për komunikimin e qasshëm. Ose, të siguroheni që një institucion publik të përdorë gjuhën e lehtë në dokumentet e veta.

Si të identifikoni çështjet kryesore dhe aktorët lokalë: Bëni një analizë të thelluar për të kuptuar sfidat kryesore në komunikimin e qasshëm në komunitetin tuaj. Identifikoni aktorët kryesorë si DPO-të lokale, OJQ-të, si dhe institucionet qeveritare, mediat, dhe sektorin privat. Kjo ju ndihmon të përmirësoni bashkëpunimin me një spektër më të gjerë organizatash.

Hapat për hartimin e një plani lokal avokimi:

- 1 **Përcaktimi i qëllimit:** Çfarë dëshironi të arrini?
- 2 **Hulumtimi dhe analiza:** Mbledhja e informacionit për çështjen dhe aktorët.
- 3 **Planifikimi i aktiviteteve:** Planifikoni aktivitete konkrete si tryeza të rrumbullakëta, ngjarje publike apo fushata ndërgjegjëse.
- 4 **Zbatimi:** Veprimi sipas planit.
- 5 **Monitorimi dhe vlerësimi:** Matja e suksesit sipas pjesëmarrjes, përfshirjes, komenteve dhe reagimit.

Modele për analizën e aktorëve dhe fletë pune: Kjo do të përfshijë formularë dhe fletë pune që ju ndihmojnë të identifikoni dhe analizoni palët e interesit, duke përfshirë rolin e tyre, interesat, nivelin e ndikimit dhe strategjinë e angazhimit.



3. Mjete për Angazhim dhe Ndikim



Modele për shkresa dhe email-e: Modele letrash drejtuar institucioneve publike me një kërkesë të qartë, si p.sh. kërkesa për takim, përkujtues për zbatimin e obligimeve ligjore ose propozime për bashkëpunim.



Udhëzues për organizimin e tryezave të rrumbullakëta dhe aktiviteteve publike: Udhëzues për të organizuar tryeza të rrumbullakëta lokale ku do të prezantohet dhe diskutohet koncepti i komunikimit të qasshëm, siç parashihen në kuadër të projektit. Udhëzuesi do të përfshijë këshilla për përzgjedhjen e pjesëmarrësve (autoritete lokale, DPO, OJQ, media), përgatitjen e agjendës dhe moderimin e diskutimeve.



Si të formoni apo t'i bashkoheni koalicioneve për komunikimin e qasshëm: Projekti synon “ndërtimin e koalicioneve dhe partneriteteve ndër-sektoriale”. Udhëzuesi do të shpjegojë si të identifikoni partnerë të mundshëm (DPO, OJQ, media, IT), si të organizoni takime dhe si të nënshkruani Memorandum Mirëkuptimi për të përcaktuar përpjekjet e përbashkëta.



Këshilla për mobilizimin e komunitetit dhe përfshirjen e mediave: Këshilla praktike për organizimin e fushatave ndërgjegjësuere online dhe offline dhe mënyra se si të bashkëpunoni me mediat dhe gazetarë individualë për të siguruar mbulim dhe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut.



Si të përgatitni dhe të prezantoni kërkesa të qarta para institucioneve: Përgatitni kërkesa të shkruara dhe verbale që janë të qarta, të bazuara në fakte dhe të lidhura me nevojat e grupeve të disavantazuara. Kërkesat duhet të synojnë zhvillimin e dokumenteve strategjike dhe kuadrit ligjor.

4. Materiale Komunikuese

Shembuj **mesazhesh dhe slogane** për fushata ndërgjegjësuese:

Një mesazh,
i qasshëm
për të gjithë.

Gjithëpërfshirja
fillon me
komunikimin.


Gjuha e lehtë,
e drejta të
informoheni
dhe kuptoni.

Modele vizuale për postera, broshura dhe postime në rrjete sociale: Dizajne të thjeshta dhe të pastra, me ngjyra dhe ikona që janë lehtësisht të dallueshme, mundësisht duke përfshirë një kod QR për qasje në versionin elektronik të materialeve.

Udhëzime për përgatitjen e materialeve në Gjuhë të Lehtë:

- Përdorni fjali të shkurtra (jo më shumë se 15 fjalë).
- Përdorni fjalor të thjeshtë, shmangni metaforat dhe shprehjet idiomatike.
- Përdorni font të qartë, të madh dhe hapësira të bollshme.
- Përdorni imazhe mbështetëse për të ilustruar pikat kryesore.

Lista e kontrollit për qasjen në dokumente publike: Një listë kontrolli për OJQ-të dhe institucionet publike për të vlerësuar qasjen në dokumentet e tyre, duke përfshirë formatin, gjuhën dhe qasjen online.



5. Burime Ligjore dhe Politike

Përmbledhje e dokumenteve kyçe:

- **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD):** me theks në rëndësinë e zbatimit të saj dhe monitorimin e saj.
- **Strategjia për të Drejtat e Përsonave me Aftësi të Kufizuara 2025-2030**
- **Strategjitë Kombëtare të Zbatimit:** një përmbledhje e strategjive dhe planeve të veprimit në Kosovë.
- **Modele për përfshirjen e klauzolave në dokumente strategjike:** Model i një klauzole: “Të gjitha dokumentet zyrtare dhe informacionet publike të komunës/institucionit do të hartohen dhe shpërndahen në formatin e Komunikimit të Qasshëm dhe Gjuhës së Lehtë për t’u kuptuar, në përputhje me standardet ndërkombëtare.”
- **Studime rasti:** Përmbledhje e praktikave të suksesshme nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, siç parashihet të prezantohen në konferencat përfundimtare të projektit.



6. Monitorim dhe Vlerësim

- **Si të matni suksesin e fushatës suaj avokuese:** Përdorni tregues specifikë, si numri i institucioneve që kanë adoptuar ndryshime konkrete. Për shembull, synimi është që 70% e organizatave që marrin pjesë në trajnime të bëjnë të paktën dy ndryshime në punën e tyre.

- **Treguesit dhe mjetet për monitorim:**

- Numri i institucioneve që kanë miratuar një politikë për komunikimin e qasshëm.
- Numri i personave të disavantazhuar që raportojnë se kanë marrë informacion të qasshëm.
- Përdorni anketa dhe fokus grupe.

- **Mjet vlerësimi vjetor për organizatat që përdorin këtë doracak:** Një mjet vlerësimi për të matur progresin dhe ndikimin e aktiviteteve avokuese, i cili mund të bazohet në raportin vjetor të monitorimit dhe të publikohet nga grupi punues.

Përdorimi i Doracakut

Kjo përmbledhje e mjeteve është e përshtatshme për:

- Trajnimin e stafit dhe vullnetarëve
- Hartimin e fushatave lokale për ndërgjegjësim dhe ndikim
- Përdorim në takime me institucionet publike
- Mbështetje për partneritete strategjike dhe lobim

Shpërndarja dhe Mbështetja

Doracaku do të shpërndahet në formë të shtypur dhe digjitale tek të gjitha OJQ-të dhe DPO-të përfituese të projektit ACTIVE II në pesë shtetet partnere.

Për mbështetje në përdorimin e Doracakut, kontaktoni zyrën lokale të Caritas në vendin tuaj.

Scano për qasje në
versionin elektronik:

